




QENDRA
E PROVIMEVE

SHIFRA
E NXËNËSIT


PROVIMI I MATURËS DHE
PROVIMI PROFESIONAL

JANAR, 2025

**GJUHË SHQIPE
DHE LETËRSI**



* A 1 3 2 1 6 6 0 *



ME RËNDËSI!

“KANDIDATI HUMB TË DREJTËN E PROVIMIT, NË ATË AFAT TË PROVIMIT, KUR GJATË PROVIMIT, PËRKATËSISHT VLERËSIMIT, VËRTETOHET SE KA PËRDORUR MJETE TË PALEJUARA, SE KA KOPJUAR DETYRËN E DIKUJT TJETËR OSE SE DETYRËN E VET IA KA DHËNË NXËNËSIT TJETËR.”

(Rregullorja për mënyrën, procedurën dhe kohën e dhënies së Provimit të Maturës në gjimnaz, neni 24; Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e dhënies së Provimit Profesional për nxënësit të cilët vazhdojnë arsimimin, neni 27)



UDHËZIM

KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA

Gjatë testit nuk lejohet përdorimi i mjeteve elektronike.

Nxënësi/nxënësja nuk guxon në asnjë mënyrë ta zbulojë identitetin e vet në test ose t'i drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Testi DUHET të shkruhet LEXUESHËM me laps kimik. Nxënësi/nxënësja mund të shkruaj me shkronja dore ose shtypi. Nëse shkruan me shkronja shtypi DUHET të theksojë shkronjën e madhe.

Testi përmban detyra të cilat zgjidhen në një të njëzën prej mënyrave në vazhdim:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë
- duke shkruar një përgjigje të shkurtër
- duke shkruar një përgjigje më të gjatë
- duke shkruar një tekst funksional
- duke shkruar ese

Me testin ke marrë edhe **fletën e përgjigjeve** për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë.

Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes të përshkruash përgjigjet tua.

Detyra do të vlerësohet me zero pikë nëse:

- është e pasaktë
- përgjigjja në detyrë me zgjedhje të shumëfishtë **NUK** është bart në fletën e përgjigjeve
- është rrethuar ose shkruar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë
- përgjigjja/eseja është e palexueshme dhe e paqartë
- përgjigjja/teksti funksional/eseja është shkruar me laps të thjeshtë
- teksti funksional/eseja **NUK** është shkruar në vendin e paraparë, por vetëm në faqet e parapara për koncept (shkrimi i konceptit nuk është i detyrueshëm)

Nëse gabon, vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe detyrën zgjidhe përsëri. Kur ta përfundosh punën, kontrolloji edhe njëherë përgjigjet tua.

Me fat!

Lexo tekstin dhe zhvillo detyrat 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Mësues i nderuar.

Djali im sot e fillon shkollën.

Pas pak, gjithçka do të jetë për të e re dhe e çuditshme, prandaj do të doja ta trajtonit butësisht. Është një aventurë që ai do ta marrë me vete nëpër të gjitha kontinentet. Të tilla aventura që ndoshta mund të përfshijnë luftëra, tragjedi dhe fatkeqësi. Ta jetosh këtë jetë, të duhet besim, dashuri dhe kurajo.

Për këtë, i dashur mësues, do t'ju lutesha ta merrnit përdore e t'i mësoni gjëra që do t'i duhen t'i dijë, mësojeni atë, por butësisht, nëse mundeni.

Mësojeni se për çdo armik, ekziston një mik.

Atij do t'i duhet të mësojë se jo të gjithë njerëzit janë të drejtë, dhe jo të gjithë njerëzit janë të sinqertë.

Megjithatë mësojeni se për çdo faqezi ka një hero dhe se për çdo politikan egoist, jeton një lider i përkushtuar.

Mësojeni nëse mundeni se 10 centë të fituar kanë shumë më tepër vlerë se një dollar i gjetur. Në shkollë, mësues, është shumë më e ndershme të dështosh se të mashtrosh. Mësojeni atë si të humbë hijshëm, dhe si t'i gëzohet fitores kur ai fiton.

Mësojeni të jetë i mirë, me njerëzit e mirë, dhe i ashpër me njerëzit e ashpër.

Mundohuni t'i qëndrojnë sa më larg zilisë, nëse do të mundeni dhe mësojani sekretin e një buzëqeshjeje të çiltër.

Mësojeni po të jetë e mundur, si të qeshë kur të jetë i trishtuar, dhe se të derdhësh lot nuk është aspak turp.

Mësojeni ti përqeshë cinikët.

Mësojeni nëse mundeni të zbulojë mrekullinë e leximit të librave, por gjithashtu i jepni edhe kohën e mjaftueshme për të kundruar misterin e përjetshëm të fluturimit të zogjve në qiell, të bletëve në diell e të luleve mbi një kodër të gjelbëruar.

Mësojeni të ketë besim në idetë e tij edhe nëse të gjithë do ti thonë se janë të gabuara. Mundohuni t'i mësoni birit tim forcën për mos e ndjekur turmën edhe kur të gjithë vrapojnë pas fitimtarit.

Mësojeni të dëgjojë me vëmendje çdo njeri, por gjithashtu të shohisë të gjithë atë që dëgjonte në sitën e së vërtetës dhe të marrë veç të mirën.

Mësojani atij se si të shesë talentin dhe zgjuarsinë e tij tek ofertuesi më i lartë, por mos të pranojë kurrë asnjë lloj çmimi për shpirtin e zemrën.

Lejojeni të ketë kurajo për të qenë i padurueshëm. Lejojeni të ketë durimin për të qenë trim. Mësojeni atë të ketë besim sublim te vetvetja, sepse atëherë ai do të ketë gjithmonë besim sublim në njerëzimin dhe në ZOTIN. Këto janë kërkesat, mësues, por ju bëni më të mirën që mundeni. Ai është fëmijë i vogël dhe i mire DHE ËSHTË BIRI IM

Me respekt,

Abraham Lincoln

/ KultPlus.com

1. Teksti është një fragment i llojit:

1. rrëfyes
2. përshkrues
3. udhëzues
4. argumentues

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë	
--------	--

2. Çfarë i kërkon në thelb prindi mësuesit?

1 pikë	
--------	--

3. Çfarë i duhet atij që të mësojë?

1 pikë	
--------	--

4. Cila kërkesë dhe mënyrë i drejtohet mësuesit?

1 pikë	
--------	--

5. Gjeni mbiemrin dhe shkallën e kategorisë në fjalinë:

Mësojeni nëse mundeni se 10 centë të fituar kanë shumë më tepër vlerë se një dollar i gjetur.

mbiemri: _____

shkalla e kategorisë: _____

2 pikë	
--------	--

Lexo fragmentin nga vepra "Xha Gorio", pastaj zhvillo detyrat 6, 7, 8 dhe 9.

"Ah, po të isha i pasur, po ta kisha ruajtur pasurinë time e të mos ua kisha dhënë, ato do të ishin këtu, do të më lanin faqet me të puthura! Do të banoja në një pallat, do të kisha dhoma të bukura, shërbëtorë, zjarr për t'u ngrohur, dhe ato do të ishin këtu, me lot për faqe, me gjithë burrat dhe fëmijët e tyre. Do t'i kisha të gjitha. Kurse tani s'kam asgjë! Ah, biri im i dashur, djali im i vetëm, më mirë që mbeta i braktisur dhe në mjerim! Të paktën, kur e duan fatzinë, ai është i sigurt që e duan me gjithë shpirt. Jo, desha të isha i pasur; do t'i kisha parë! Ato të dyja kanë zemër prej guri. Kaq e madhe ishte dashuria ime për to, sa që s'mbetej vend për dashurinë e tyre ndaj meje. Një atë duhet të jetë gjithmonë i pasur, duhet t'i mbajë për freri fëmijët e tij, si kuajt e hazdisur. Kurse unë rrija në gjunjë para tyre. Faqezetat! Po e kurorëzojnë denjësisht sjelljen që kanë treguar ndaj meje këto dhjetë vjetët e fundit.

Nuk e dini ju se sa kujdeseshin ato për mua kohët e para të martesës së tyre! (Oh! ç'martirizim mizor!) U dhashë të dyjave nga tetëqind mijë franga, s'kishin si të silleshin keq me mua, as ato, as burrat e tyre. Pa t'i shikoje si më prisnin. "Këtu babush, atje babaçko". Gjithnjë shtruar do ta gjeja tryezën tek ato, me një fjalë haja bashkë me burrat e tyre që më nderonin shumë. U dukej se unë diç kisha akoma. Pse vallë unë s'kisha folur kurrë për tregtinë time, një njeri që u jep të bijave nga tetëqind mijë franga prikë, e vlen që të përkujdesesh për të. Dhe, ato më s'dinin ç'të bënin, po u bënin nderë parave të mia, jo mua. Ç'botë e qelbur! Ia kam pirë lëngun unë! Më shpinin në karrocë në teatër, dhe, kur më pëlqente, rrija në mbrëmjet që bënin. Shkurt, ato s'e kishin për turp që ishin për turp që ishin vajzat e mia. S'jam unë budalla, unë, jo, mos kini merak, të gjitha i kam vënë re. Gjithë plumbat kanë goditur në shenjë dhe më kanë përshkuar zemrën. E shihja fare mirë unë që ma kishin me djallëzi; po qe sëmundje që s'kishte ilaç. Në tryezën e tyre rrija si mbi gjemba, s'e ndieja mirë si në tryezën e pensionit. Unë s'dija të thosha dy fjalë bashkë dhe, kur i pyeste dhëndurët e mirë ndonjë nga ata zotërinjtë e shoqërisë së lartë: "Kush është ky zotëria?" ata i përgjigjeshin: "Është babai i florinjve, është i pasur". "Hej, djalli!" – ia bënte ai dhe më vështronte me respektin që u bëhet florinjve. Po dhe në bezdiseshin ndonjëherë nga unë, ua shpërbleja dyfish me të mira atë bezdi. Fundja, kush është i përsosur? (Plagë e kam këtë të shkretë kokë!) Unë heq e vuaj tani gjithë sa mund të vuajë njeriu kur jep shpirt, o i dashur Eugjen, po të gjitha këto s'janë asgjë përpara dëshpërimit që më shkaktoi vështrimi i parë i Anastasisë, ai më dha të kuptoja se kisha thënë një marrëzi që e kisha fyer. Vështrimi i saj më futi në dhe të gjallë. Do të desha t'i mësoja të gjitha, por vetëm një gjë kuptova mira: që isha i tepërt në këtë botë.

O Perëndi! Po meqë Ti e di se ç'të zeza kam hequr, meqë ti i ke numëruar thikat që kam marrë në atë kohë që më plaku, që më nxiu, që më vrau, që më thinji, pse më bën të vuaj sot? Unë e kam larë mëkatën që i kam dashur tepër. Ato janë shpëguar për dashurinë time, më kanë torturuar si xhelate. Ah, sa budallenj janë prindërit! I doja aq shumë, sa që prapë shkova tek to, si ai kumarxhiu në bixhoz. Vajzat e mia ishin vesi im: ato ishin padronet e mia, ishin gjithçka për mua!...(Më dhemb, më dhemb shumë, o zot! Mjekët, ku janë mjekët, sikur të ma hapnin kokën, nuk do vuaja kaq shumë.) Anastasinë! Delfinën! Dua t'i shoh! Dërgoni merrini me policë, me forcë! Drejtësia është me mua, të gjithë janë me mua, natyra, Kodi Civil. Unë protestoj! Atdheu do të shkatërrohet, në qoftë se prindërit merren nëpër këmbë..."

6. Cilit drejtim letrar i përket vepra.

1 pikë	
--------	--

7. "Komedia njerëzore" e Balzakut përbëhet nga tri seri të mëdha, gjej se ku bën pjesë romani "Xha Gorio":

1. studimet për zakonet
2. studimet filozofike
3. studimet analitike

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë	
--------	--

8. Tema kryesore e romanit " Xha Gorio " është":

1 pikë	
--------	--

9. Nga çfarë vuan Xha Gorio:

1 pikë	
--------	--

Lexo fragmentin në vazhdim dhe zhvillo detyrën 10.

Paqë, jo, nuk gjej, e luftë s'kam me njeri,
Kam frikë e shpresë, digjem e akulloj,
Në qiell fluturoj, por prapë në tokë rri,
S'përqafoj kend e botën në krahë pushtoj.

Rob i saj jam, s'më kyç as jep liri,
S'më do për vete e lakut s'i dredhoj,
S'më vret e prangat më lë kjo dashuri,
Të gjallë s'më do e s'mundem t'i shpëtoj.

Shikoj pa sy, gjuhë nuk kam e bërtas,
E dua të vdes, e prapë kërkoj ndihmë;
Veten urrej, ndërsa të huajin dua.

Dhimbja më ushqen e vaji më del me gaz;
As jeta as vdekja s'më pëlqejnë një grime,
Në këtë gjendje jam nga ti, o grua!.

10. Për nga forma si quhet kjo poezi?

1 pikë	
--------	--

11. Radhit qytetërimet e lashta sipas zanafillës së shkrimit:

Qytetërimi: sanskrit, greko-romak, sumer, egjiptian

1 pikë	
--------	--

Lexo vargjet dhe zhvillo detyrat 12, 13 dhe 14.

Ca pika shiu ranë mbi qelq
për ty unë befas ndjeva mall,
jetojmë të dy në një qytet
dhe rrallë shihemi, sa rrallë.

Edhe m'u duk kaq e çuditshme
si erdh kjo vjeshtë, ky mëngjes.
qiejt e ngrysur pa lejlekë
dhe shirat pa ylber në mes.

Dhe thënia e vjetër e Heraklitit
seç m'u kujtua sot për drejt:
"Të zgjuarit janë bashkë në botë,
kurse të fjeturit janë veç".

Në ç'ëndërr kemi rënë kaq keq,
që dot s'po zgjohemi ne vallë?...
Ca pika shiu ranë mbi qelq
dhe unë për ty seç ndjeva mall.

12. Cili është motivi i kësaj poezie?

1 pikë

**13. Në vargjet: "Qiejt e ngrysur pa lejlekë/ dhe shirat pa ylber në mes"
gjeni figurën letrare dhe tregoni çfarë referohet?**

Figura letrare: _____

I referohet _____

2 pikë

14. Krahasoni dy vargjet e para të strofës së parë me dy vargjet e fundit të strofës së fundit. Cili është ndryshimi?

2 pikë

15. Vetëm njëra nga karakteristikat ka të bëjë me karakterin e Emës tek vepra Zonja Bovari të Gustav Floberit, veçoje atë dhe argumento përgjigjen.

Është viktimë _____ ka problem të rënda shëndetësore,

paraqet përsosmërinë e figurës së gruas

2 pikë

Lexo fragmentin nga *Krim e ndëshkim* – Takimi me nënën (Fjodor Dostojevski) dhe zhvillo detyrën 16.

Po atë ditë, në mbrëmje, Raskolnikovi shkoi në dhomën e mamasë dhe të motrës. Ua kishte gjetur Razumihni në shtëpinë e Bakaljevit. Deri tek dera kishte qenë me mëdyshje, të hynte apo të mos hynte. Vendosi të hynte. "Ata nuk dinin asgjë ... janë mësuar të më mbajnë për të çuditshëm", - tha me vete. Natën e shkuar e kishte kaluar jashtë, ishte zhubrosur dhe fëlliqur për ibret. Mezi mbahej në këmbë nga lodhja fizike, por edhe nga kapja e tmerrshme shpirtërore. Pas asaj nate të kaluar s'di se ku, e kishte marrë të prerë vendimin: do dorëzohej.

Trokiti në derë, ia hapi e ëma. Dunjeçka nuk ishte aty. Pulheria Aleksandrova shtangu kur e pa, u gëzua aq shumë, sa s'po dinte as ç'të thoshte; e kapi nga krahu dhe e futi Brenda.

16. A) Subjekti i këtij romanit është:

1. keqardhja dhe trishtimi
2. e vërteta hyjnore dhe ligji tokësor
3. nervozizmi dhe revolta
4. kush guxon ai ka dhe të drejtë

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë	
--------	--

B) Argumentoje përgjigjen.

1 pikë	
--------	--

17. Si quhet vepra e F. Kafkës në të cilën përqendrohet e jashtëzakonshmja e fantastikes me realen?

1 pikë	
--------	--

18. Lexo vargjet nga *Albatrosi* (Sharl Bodler) dhe përgjigju në pyetjen në vazhdim.

Ky **sovran** i kaltërsisë, pas kuvertës ngjitur,
Si i zënë ngushtë nga pamundësia e tij,
Mjerisht, krahët e bardhë, i lë të zvarritur,
Si një çift rremash të vozitura me ngadalësi.

A) Sqaro kuptimin e fjalës së nënvizuar sovran.

1 pikë

B) Cila figurë letrare është përdorur në vargjet e shkëputura.

1 pikë

19. Në fjalinë " U kthyen duarbosh në shtëpi", -u- është:

1. pjesëz e diatezës veprorë
2. pjesëz e diatezës joveprorë
3. trajtë e shkurtër
4. trajtë e bashkuar

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

20. Gjeni një rrethanor në fjalinë e mëposhtme dhe tregoni llojin e tij.

Aty-këtu, ca re, si elefantë të ngarkuar me pambuk, endeshin ngadalë.

Rrethanori _____

Lloji _____

2 pikë

21. Në fjalinë "Dyshimi i zi për njerëzit do të ulet gjithmonë mbi ballin tim", gjymtyrët e fjalisë kryejnë funksionet:

e kryefjalës _____, të përcaktorëve _____,
kallëzuesit _____, të rrethatorëve _____.

2 pikë	
--------	--

22. Lexo tekstin dhe përgjigju në pyetje.

Hanko mos kalo mbi valle,
Se **të vdekurit i ngjalle,**
Të gjallët i vdiqe fare

Fjalët e vargjeve të mësipërme shënojnë:

1 pikë	
--------	--

23. Rishkruaje tekstin duke respektuar drejtshkrimin.

Radio televizioni shqiptar fton të gjithë krijuesit dhe interpretuesit të marrin pjesë në konkurrim për të qenë pjesëmarrës në festivalin e 59 të këngës. Përzgjedhja e këngëve pjesëmarrëse do të kryhet nga Komisioni i seleksionimit të këngëve në bazë të dëgjimit të tyre. Konkurrentët duhet të dorëzojnë pranë stafit të festivalit në radio tirana ose në postën elektronike festival@rtsh.al këngën e plotë me të gjitha specifikimet teknike si më poshtë.

2 pikë	
--------	--

24. Shkruaj një kërkesë (numër: 136/08) me të cilën i drejtoheni Këshillit të Arsimitarëve të shkollës së mesme të përzier “25 Maji” në Tuz që të jep mundësin të organizoni një ekspeditë tre ditore me mësimdhënësit e artit figurativ dhe të filozofisë që të vizitoni Kalanë e Krujës, Galerinë e Arteve dhe Muzeun Kombëtar.

Respektoni formën e tekstit, me të gjitha të dhënat e domosdoshme që duhet t’i ketë një kërkesë si dhe respektoni gjuhën standarde.

8 pikë	
--------	--

KONCEPTI I KËRKESËS

KËRKESA

25. Janë dhënë dy tema për hartimin e esesë. Rretho numrin para temës të cilën e ke zgjedhur dhe shkruaje esenë që duhet të ketë nga 250 deri në 300 fjalë.

• Me rastin e zhvillimit të temës, shfrytëzo shembujt relevant/të dhënat dhe argumento qëndrimet personale.

• Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHEM FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi). Eseja DUHET të shkruhet në fletët e parapara për shkrimin e esesë (eseja e shkruar në fletët e konceptit NUK LEXOHEM).

• Bëj kujdes për saktësinë gjuhësore dhe që teksti të jetë i lexueshëm.

1. "Procesi" F. Kafka

UDHËZIME PËR SHKRIMIN E ESESË:

- Shkruaj tiparet themelore të veprës (autorin, llojin letrar, drejtimin dhe titullin)
- Përshkruaj ngjarjet në roman që ndjekin rrjedhën e kryepersonazhit.
- Thekso gjykimin aktin e krimit dhe të dënimit.

2. Shih botën brenda një zemre

UDHËZIME PËR SHKRIMIN E ESESË:

- Shpreh mendimin rreth temës dhe kuptimit që shpreh fjala zemër, ndjenjën ndaj njeriut, ndaj atdheut, vetë ndërgjegjësimin e kësaj ndjenje.
- Shkruaj për lidhjen e fortë me diçka që adhuron, dëshiron, ndjen që të jetë pjesë e juaja.
- Trego sa jemi të ndërgjegjshëm dhe botën e shohim brenda një zemre.

13 pikë	
---------	--

